



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.10.2022, ora 15.00

Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi
Rendi i Ditës:

1. Fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit Përparim Kalo, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022;

2. Të tjera.

Marrin pjesë:

1. Sokol Binaj	(Kryetar)
2. Marsida Xhaferllari	(zëvendës kryetare)
3. Elsa Toska	(anëtare)
4. Anila Leka	(anëtare)
5. Klodiana Mema (Veizi)	(anëtare)
6. Etien Kapo	(anëtar)
7. Enton Dhimitri	(anëtar)
8. Sandër Simoni	(anëtar zëvendësues)
9. Altin Binaj	(anëtar zëvendësues)

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. **Enio Haxhimihali**, përfaqësues me autorizim i Avokatit të Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Alket Jaupi** – përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
2. **Mimoza Arbi** – përfaqësuese me autorizim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

Me pjesëmarrjen e përfaqësues së OPDAT-it, **përfaqësuesja Klodiana Vogli**

HAPET MBLEDHJA: ora 15.12 min

Kryetari Sokol Binaj – Deklaroj të hapur mbledhjen e caktuar për ditën e sotme, me rend dite *“Fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit Përparim Kalo, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022”*.

Verifikojmë prezencën e pjesëmarrësve.

Të pranishëm anëtarët; Marsida Xhaferllari, zonja Toska, z. Dhimitri, z. Kapo, znj. Klodiana Mema (Veizi). Janë të pranishëm përfaqësuesit e Avokatit të Popullit z. Enio Haxhimihali. Përfaqësuesi i Presidentit të Republikës z. Jaupi. Përfaqësuesja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Mimoza Arbi. Përfaqësuesja e OPDATE-it znj. Klodiana Vogli.

Nuk janë të pranishëm anëtarët Genti Xholi dhe Edlira Petri kanë njoftuar dhe verbalisht dhe shkresërisht për pamundësinë e tyre në mbledhjen e sotme, pra, kanë marrë dijëni por në pamundësi për tu paraqitur për shkak të impenjimeve me shërbime jashtë vendit. Anëtarja Anila Leka ka marrë dijëni. Në komunikim e sipër ajo është duke ardhur në rrugë e sipër. Kemi kuorumin për të vazhduar me rendin e ditës. Rendi i ditës është pikërisht momenti kur mbaruam më verifikimin e vakancës të shpallur nga Presidenti i Republikës, përfundimi i relacioneve, në aplikim të nenit 239 të ligjit nr. 115/2016 jemi në momentin procedural për të deklaruar për të filluar me pikëzimin, renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur në vakancën e Presidencës tek mandati i përfunduar të zotit Kalo.

Jemi dakort atëherë! Nuk kemi asnjë kundërshtim.

Unanimisht pjesëmarrësit janë dakort për deklarimin e fillimit të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve.

Të caktojmë një datë brenda 10 ditëshit nga momenti i mbledhjes së sotme për të filluar procesin e pikëzimit, për të dëgjuar intervistat e tre kandidatëve si dhe për të thirrur ekspertët. Bëhet fjalë për ekspertët e gjuhës së huaj në Gjermanisht dhe në Anglisht që do të vlerësojnë njohurit e kandidatëve lidhur me këto dy gjuhë anglishten dhe me Gjermanishten.

Elsa Toska – një sugjerim Kryetar, po ka mundësi. Duke qenë së unë kam qenë në komunikim të vazhdueshëm me kandidatët nëpërmjet këshilltarve që të sjellin sipas vendimit të KED-së pikës 32 pesë dokumente për vlerësim, të sjellin platformën e përditësuar duke patur parasysh që koha ka qenë e gjatë, ata i kanë bërë aplikimet në shkurt, shkoi tetori kështu që do të ishte serioze dhe shumë më e arsyeshme që kandidatët të rifreskonin dhe platformat personale, ndërkohë i kam pyetur edhe për ekspertët që do të thotë që brenda ditës së sotme ata kanë sjell të gjitha dokumentet dhe po brenda ditës së sotme sekretaria do tu shpërndaj gjithë anëtarve që të njihen, të kenë mundësi ti lexojnë kështu që mendoj unë në mënyrë të arsyeshme sot është e mërkurë tu vihen në dispozicion anëtarve këto pesë dokumente. Mesa i pashë unë kanë goxha volum, ndërkohë dokumentet kishin material voluminoz që do të thotë mendoj unë nga sot ta zëmë edhe fundjavën brenda dhe nga e hëna e tutje. Kjo edhe për një arsye tjetër pasi unë vetë duke pritur dokumentet relacionet nuk mund t’ju vijmë më parë sesa e hëna në mëngjes, në këtë kuptim marrim parasysh këto elemente.

Anëtarët flasin pa mikrofon

Sokol Binaj-Prezantojmë prezencën e anëtares Anila Leka, e cila u paraqitë në këtë moment. Konkluduar, ramë dakort me rendin e ditës që jemi mbledhur për të proceduar me fillimin e pikëzimit.

Dakort

Mirë atëherë, mbledhja e ardhshme do të jetë në **datë 26.10.2022, ora 14.00**, për të filluar më procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit Përparim Kalo, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022.

Të njoftohen kandidatët për intervistën, duke e dokumentuar atë intervistë që do të paraqesin këtu si dhe ekspertët e gjuhëve të huaja, ajo e anglishtes dhe ajo e gjermanishtes.

Deklaroj të mbyllur mbledhjen për sot.

Tiranë më datë 19.10.2022

KRYETAR

Sokol BINAJ

